

VENDIM
Nr.1260, datë 23.12.2009

PËR MIRATIMIN E LISTËS SË VENDEVE TË TRETA TË SIGURTA

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 28/1 të ligjit nr.8432, datë 14.12.1998 “Për azilin në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e listës së vendeve të treta të sigurta, sipas shtojcës nr.1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.
 2. Herë pas here apo kur zhvillimet në një ose më shumë vende mund të sjellin ndryshime në kushtet e atij/atyre vendeve, në përputhje me nenin 28/1 të ligjit nr.8432, datë 14.12.1998 “Për azilin në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, Ministri i Brendshëm propozon ndryshimin e kësaj liste.
 3. Në përgatitjen e ndryshimeve në listën e vendeve të treta të sigurta mbahen parasysh të dhënat, që merren nga organet e specializuara të shtetit shqiptar për përfitimin e informacionit nga vendet e origjinës, listat e hartuara për qëllime të ngjashme nga shtete apo organizata ndërkombëtare, si dhe mendimi përkatës i UNHCR-së ose i organizatave ndërkombëtare për të drejtat e njeriut.
 4. Ngarkohet Ministria e Brendshme për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Shtojca nr.1

LISTA E VENDEVE TË TRETA TË SIGURTA

Vendet që përfshihen në listën e vendeve të treta të sigurta, paraqiten në vijim:

- | | |
|--------------------|------------------------------------|
| 1. Australia | 19. Letonia |
| 2. Austria | 20. Lituania |
| 3. Belgjika | 21. Luksemburgu |
| 4. Bullgaria | 22. Malta |
| 5. Danimarka | 23. Mbretëria e Bashkuar |
| 6. Estonia | 24. Norvegjia |
| 7. Finlanda | 25. Polonia |
| 8. Franca | 26. Portugalia |
| 9. Greqia | 27. Qipro |
| 10. Gjermania | 28. Republika Çeke |
| 11. Holanda | 29. Rumania |
| 12. Hungaria | 30. Sllovakia |
| 13. Irlanda | 31. Sllovenia |
| 14. Islanda | 32. Spanja |
| 15. Italia | 33. Suedia |
| 16. Japonia | 34. Shtete e Bashkuara të Amerikës |
| 17. Kanadaja | 35. Zelanda e Re |
| 18. Koreja e Jugut | 36. Zvicra |